

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

Raportimi Financiar i Avancuar
Advanced Financial Reporting

P9

Zgjidhjet

Data
22/01/2022

1. Shishaldin sh.a ndër vite ka ndjekur një strategji rritjeje përmes blerjeve brenda industrisë prodhuese. Draft pasqyrat e pozitës financiare të Shishaldin sh.a dhe të investuarve të saj Poas sh.a dhe Agung sh.a më 31 dhjetor 2021 janë si më poshtë:

Pasuritë	Shishaldin sh.a	Poas sh.a	Agung sh.a
	€'m	€'m	€'m
<i>Jo-qarkulluese</i>			
Pasuritë e patun., imp.e prodhimit dhe paisjet	500	375	425
Investimt në:			
Poas sh.a	300	-	-
Agung sh.a	<u>230</u>	<u>150</u>	<u>—</u>
	1,030	525	425
<i>Qarkulluese</i>	<u>150</u>	<u>175</u>	<u>200</u>
Total pasuritë	1,180	700	625
Ekuiteti dhe detyrimet			
<i>Ekuiteti</i>			
Kapitali aksionar	250	125	125
Fitimet e mbjatura	580	400	350
Rezervat tjera	<u>100</u>	<u>50</u>	<u>100</u>
	930	575	575
Detyrimet afatgjata	150	75	30
Detyrimet afatshkurtra	<u>100</u>	<u>50</u>	<u>20</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	1,180	700	625

Informatat në vjijim janë të rëndësishme:

i) Shishaldin sh.a bleu 60% të aksioneve të Poas sh.a-së më 1 janar 2016 me një kosto prej €250 milionë kur fitimet e mbajtura dhe rezervat e tjera të Poas sh.a arritën në €230 milionë dhe €32.5 milionë respektivisht. Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Poas sh.a në 1 janar 2016 ishte €400 milionë. Diferenca midis vlerës së drejtë dhe vlerës në libra të pasurive neto të identifikueshme të Poas sh.a më 1 janar 2016 i atribuohet një zëri të impiantit të prodhimit që në atë datë kishte një jetë ekonomike të dobishme të mbetur prej tetë (8) vitesh.

Pjesa e mbetur prej 40% të aksioneve të Poas sh.a kishte një vlerë të drejtë €167 milion në atë datë. Është politikë e grupit për të matur interesin jo-kontrollues me vlerën e drejtë në datën e blerjes.

ii) Shishaldin sh.a bleu 35% të aksioneve të Agung sh.a-së më 1 janar 2019 me një kosto prej €100 milion kur fitimet e mbajtura dhe rezervat e tjera të Agung sh.a arritën në €100 milion dhe €25 milion respektivisht. Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme të Agung sh.a më 1 janar 2019 ishte e barabartë me vlerën e tyre në libra. Zotërimi i 35% i dha Shishaldin sh.a-së një influencë domethënëse në Agung sh.a.

iii) Poas sh.a bleu 20% të aksioneve të Agung sh.a-së më 1 janar 2020 me një kosto prej €125 milion kur fitimet e mbajtura dhe rezervat e tjera të Agung sh.a-së arritën në €300 milion dhe €75 milion respektivisht. Vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme

të Agung sh.a-së më 1 janar 2020 ishte €55 milion. Diferenca midis vlerës së drejtë dhe vlerës në libra të pasurive neto të identifikueshme të Agung sh.a-së më 1 janar 2020 i atribuohet një zëri të impiantit të prodhimit që në atë datë kishte një jetë ekonomike të dobishme të mbetur prej dhjetë (10) vitesh.

Vlera e drejtë e pronësisë prek 35% në Agung sh.a më 1 janar 2020 ishte €218.8 milion ndërsa ajo e një pronësie prej 47% dhe një pronësie 53% ishte përkatësisht €293.8 milion dhe €331.3 milion respektivisht.

- iv) Të gjitha pasuritë e investimit në aksione të ekuitetit janë klasifikuar si zëra me vlerë të drejtë përmes të ardhurave të tjera gjithëpërfshirëse (VDNTTGJ) në pasqyrat financiare të veçanta të entiteteve investuese më sipër në përputhje me SNRF 9 *Instrumentet Financiare*.
- v) Pëe shkak të blerjeve të stoqeve nga Agung sh.a, stoqet në fund të Poas sh.a-së më 31 dhjetor 2021 përfshin artikuj të blerë nga Agung sh.a me një çmim prej €25 milion. Agung sh.a faturon Poas sh.a-në me një marzhë mbi kosto prej 25%.
- vi) Nuk kishte pasur humbje nga dëmtimi në lidhje me investimet në Poas sh.a dhe Agung sh.a përpara datës 1 janar 2021. Një rishikim i investimeve më 31 dhjetor 2021 tregon se shumata e rikuperueshme të Poas sh.a dhe Agung sh.a si njësi gjeneruese të parasë në 31 dhjetor 2021 janë €550 milion dhe €650 milion respektivisht.
- vii) Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe paisjet e Shishaldin sh.a përfshijnë një ndërtesë që u ble më 1 janar 2011 me një kosto prej €55 milion. Ndërtesa është duke u zhvlerësuar për një jetë totale prej 50 vitesh në bazë lineare me vlerë të mbetur zero. Ndërtesa është rivlerësuar për herë të fundit më 31 dhjetor 2019 në një vlerë të drejtë prej €44 milion. Ndërtesa ende nuk është rivlerësuar më 31 dhjetor 2021 në një vlerë të drejtë prej €43.5 milion.

Kërkohet:

Pergatite Pasqyrën e Konsoliduar të Pozitës Financiare të grupit Shishaldin sh.a me 31 dhjetor 2021. (30 pikë)

Grupi Shishaldin sh.a PKPF me 31 dhjetor 2021

Pasuritë	€'m
<i>Jo-qarkulluese</i>	
Pasuritë e patun., imp.e prodhimit dhe paisjet (L11)	945.6
Zëri i mirë (L12)	<u>436</u>
	1,381.6
Qarkulluese (150+175+200-25X25/125)	<u>520</u>
Total pasuritë	1,901.6
Ekuiteti dhe detyrimet	
<i>Ekuiteti</i>	
Kapitali aksionar	250
Fitimet e mbajtura (L14)	571.5
Rezervat tjera (L15)	140.4
Interesat jo-kontrollues (L16)	<u>514.7</u>
Total ekuiteti	1,476.6
Detyrimet afatgjata (150+75+30)	255
Detyrimet afatshkurtra (100+50+20)	<u>170</u>
Total ekuiteti dhe detyrimet	1,901.6

Llogaritjet

L11. Pasuritë e patun., imp.e prodhimit dhe paisjet	€'m
Shumat e dhëna:	
Shishaldin	500
Poas	375
Agung	<u>425</u>
	1,300
Korigjimet:	
VD në blerje:	
Poas (400-[125+230+32.5])	12.5
Agung (55-[125+300+75])	(445)
Zhvlerësimi shtesë në VD:	
Poas 12.5/8x6	(9.4)
Agung (445)/10x2	89
Rivlerësimi i PP. IP&P të Shishaldin (43.5-44x39/41)	1.6
Poas humbja nga dëmtimi atribuar tek PP. IP &P (L13)	<u>(3.1)</u>
	945.6

L12. Zëri i mirë ne blerjen e:

i) Poas	€'m
Kosto e blerjes	250
IJK në blerje	167
Minus VD e PN te identifikueshme në blerje	<u>(400)</u>
Zëri i mirë në blerje	17
Minus humbja nga dëmtimi (L13)	<u>(17)</u>
Vlera bartëse me 31 dhejtor 2021	0
ii) Agung	
Kosto e blerjes (218.8+60%x125)	293.8
IJK në blerje (VD of 53% pronësi)	331.3

Minus VD e PN te identifikueshme në blerje	(55)
Zëri i mirë në blerje	570.1
Minus humbja nga dëmtimi	(134.1)
Vlera bartëse me 31 dhejtor 2021	436

L13. Rishikimi për dëmtim i NJGJP të Poas dhe Agung:

	€'m
i) Poas	
Vlerat bartëse me 31 dhjetor 2021:	
Identifikueshme:	
E dhënë (ekuiteti)	575
Neto përfitimi nga VD (12.5-9.4)	3.1
Anulimi i përfitimit në investimet e Agung (150-125)	(25)
	553.1
Zëri i mirë	17
Total	570.1
Shumat e rikuperueshme (e dhënë në pyetje)	550
Total humbja (570.1-550)	20.1
Alokuar tek zëri i mirë	(17)
Saldo alokuar tek PP. IP &P	3.1
ii) Agung	
Vlerat bartëse me 31 dhjetor 2021	
Identifikueshme:	
Dhënë (ekuiteti)	575
Neto përfitimi nga VD (-445-(-89))	(356)
Fitimi i perealizuar 25 x 25/125	(5)
	214
Zëri i mirë bruto	570.1
Total	784.1
Shuma e rikuperueshme (dhënë)	650
Total humbja (784.1-650)	134.1
Alokuar tek zëri i mirë (maksimum)	(134.1)

L14 Fitimet e mbajtura të grupit		€'m
Shishaldin FM		580
Pjesa e FM pas blerjes		
Poas 60%(400-230)		102
Agung (35%[300-100]+47%[350-300])		93.5
Korigjimet:		
Analumi i përfitimeve në rimatjen e pasurive nepermejt VDTTGJ		
- Investimet e Shishaldin në Poas (300-250)		(50)
- Investimet e Shishaldin në Agung (230-100)		(130)
- Investimet e Poas në Agung (150 – 125)x60%		(15)
Përfitimi në ç' njuhjen e shoqerisë Agung:		
Vlera e drejtë në datën e ç' njuhjes		218.8
Vlera bartëse e shoqërisë (vlera e ekuitetit):		
Kosto	100	
Pjesa pas blerjes e		
FM35%(300-100)	70	
Rezervave tjera 35%(75-25)	<u>17.5</u>	
		<u>(187.5)</u>
		31.3
Zhvl akumul. VD:		
- Poas 9.4x 60%		(5.6)
- Agung -89x 47%		41.8
Fitimi i përealizuar ne stoqe 5x47%		(2.4)
Rivlerësimi i PP. IP &P të Shishaldin:		
Total përfitimi (L11)	1.6	
VD në rivlerësim	43.5	
Modeli i kostos vlera bartëse 55x 39/50	42.9	
Shuma para rivlerësimit 44 x 39/41	41.9	
Andaj fitimi i raportuer tek F/H (42.9-41.9)		1.0
Humbja nga dëmtimi (L13):		
- Zëri i mirë në Poas 60%x17		(10.2)
- Zëri i mirë në Agung 47%x134.1		(63)
- PP. IP &P në Poas 60%x3.1		<u>(1.9)</u>
		571.5
L15. Rezervat tjera		€'m
Rezervat tjera tezervat tjera të Shishaldin		100
Pjesa e FM pas blerjes së:		
Poas 60%(50-32.5)		10.5
Agung (35%[75-25]+47%[100-75])		29.3
Rivlerësimi i PP. IP &P të Shishaldin:		
Total përfitimi (L11)	1.6	
Minus përfitimi në F/H (L14)	<u>(1)</u>	<u>0.6</u>
		140.4
L16. IJK		€'m
i) Poas		167
Në blerje		

Ndryshimet pas berjes:	
FM 40%(400-230)	68
VD zhvlerësimi 40%x 9.4	(3.8)
Anulimi i përfitimit në investimet në Agung 40%(150-125)	(10)
Pjesa e koston së invetimeve të Poas në Agung 40%x125	(50)
Humbjet nga dëmtimi në rishikimin e NJGJP tëPoas:	
Humbja nga dëmtimi 40%x 17	(6.8)
PP. IP &P 40%x 3.1	(1.2)
Rezervat tjera 40%(50-32.5)	<u>7</u>
	170.2
ii) Agung	€'m
Në blerje	331.3
Ndryshimet pas blerjes:	
FM 53%(350-300)	26.5
VD zhvlerësimi 53% x 89	47.2
Humbja e ZM 53%x 134.1	(71.1)
Fitimet e porealizuara 53%x 5	(2.7)
Rezervat tjera 53%(100-75)	<u>13.3</u>
	344.5

2. Kanaga sh.a nje grup i shitjes me pakicë operon në pjesë të ndryshme të botës. Kanaga sh.a i raporton menaxhmentiti në baza regjionale. Rezultatet e segmenteve regjionale për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021 janë si në vijim:

Regjioni	Total të hyrat €' milion	Fitimi/humbja €' milion	Pasuritë €'milion	Detyrimet €' milion
Europian	134	22	236	100
Afrikan	20	(4)	36	150
Aziatik	24	2	38	50
Amerikan	<u>94</u>	<u>(12)</u>	<u>108</u>	<u>200</u>
Total	272	8	418	500

Kërkohet:

Diskuto se cili nga segmentet operative të Kanaga sh.a-së përbëjnë segment operativ të raportueshëm sipas SNRF 8 *Segmentet operative* për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021.
(10 pikë)

2.

Segment operativ është një komponent [përbërës] i një entiteti:

- (a) I cili merret me aktivitete biznesi nga të cilat mund të gjenerohen të hyra dhe të ndodhin shpenzime (përfshirë të hyrat dhe shpenzimet që kanë të bëjnë me transaksionet me komponentë [përbërës] të tjerë të të njëjtit entitet)
- (b) Rezultatet operative të të cilit rishikohen rregullisht nga vendim - marrësit kryesorë operativë [ekzekutivë] të entitetit të cilët marrin vendime për sa i takon burimeve që do të duhet të shpërndahen ndaj segmentit dhe vlerësojnë performancën e tij, dhe
- (c) Për të cilin janë në dispozicion informacione financiare të veçanta

SNRF 8 kërkon që një entitet të raportojë informacion financiar dhe përshkrues në lidhje me segmentet e raportueshme. Segmentet e raportueshme janë segmente operative ose grumbullime të segmenteve operative që plotësojnë kriteret e specifikuar:

- të ardhurat e raportuara të tij, si nga klientët e jashtëm, ashtu edhe nga shitjet ose transferimet e sektorëve, janë 10 për qind ose më shumë të të ardhurave të kombinuara, të brendshme dhe të jashtme, të të gjithë segmenteve operative; ose
- masa absolute e fitimit ose humbjes së raportuar është 10 për qind ose më shumë nga më e madhe, në shumën absolute, e (i) fitimit të raportuar të kombinuar të të gjithë segmenteve operative që nuk raportuan një humbje dhe (ii) humbjes së kombinuar të raportuar të të gjithë segmenteve operative që raportuan humbje; ose
- pasuritë e tij janë 10 për qind ose më shumë të pasurive të kombinuara të të gjithë segmenteve operative.

Nëse të ardhurat totale të jashtme të raportuara nga segmentet operative përbëjnë më pak se 75 për qind të të ardhurave të entitetit, segmentet operative shtesë duhet të identifikohen si segmente të raportueshme (edhe nëse nuk plotësojnë pragjet sasiore të përcaktuara më sipër) deri në të paktën 75 për qind të të ardhurat e entitetit përfshihen në segmentet e raportueshme.

Me 31 dhjetor 2021 tre prej kater segmenteve operative janë segmente operative të raportueshme:

- Regjioni Evropian dhe Amerikan i përmbush të gjitha kriteret.
- Regjioni Afrikan raportohet ndarazi për shkak se humbja është më e madhe se 10% e total fitimeve të segmentit (4/24 or 16.7%).

3.

a) Barva sh.a është një kompani ndërkombëtare me prezencë në Kosovë që ofron pjesë këmbimi për industrinë e automobilave. Ajo operon në shumë juridiksione të ndryshme me monedha të ndryshme. Gjatë vitit 2020, Barva sh.a përjetoi vështirësi financiare pjesërisht për shkak të pandemisë COVID-19 duke shënuar nga një rënie e të ardhurave, një riorganizim dhe ristrukturim të biznesit dhe si rezultat raportoi një humbje për vitin. Është kryer një test dëmtimi i emrit të mirë, por nuk është njohur asnjë dëmtim. Barva sh.a aplikoi një normë skontimi për të gjitha rrjedhat e parasë për të gjitha njësitë gjeneruese të rrjedhave të parasë (NJGJP), pavarësisht nga valuta në të cilën do të gjeneroheshin rrjedhat e parasë. Norma e skontimit e përdorur ishte kostoja mesatare e ponderuar e kapitalit (KMPK), dhe Barva sh.a përdori normën e obligacioneve qeveritare 10-vjeçare pa rrezik në valutën euro si normë pa rrezik në këtë përlllogaritje.

Për më tepër, Barva sh.a ndërtoi modelin e saj duke përdorur një parashikim të shprehur në valutën funksionale të kompanisë mëmë. Barva sh.a mendoi se çdo qasje tjetër do të kërkonte një nivel detajesh që do të ishte joreale dhe e pamundur. Barva sh.a argumentoi se NJGJP -të e ndryshme përfaqësonin profile të ndryshme rreziku në afat të shkurtër. Megjithatë, nuk kishte asnjë bazë për të pretenduar se profilet e tyre të rrezikut ishin të ndryshme gjatë një cikli më të gjatë biznesi.

Barva sh.a ka testuar për dëmtim pasuritë e saj afatgjata. U vendos që një ndërtesë e vendosur jashtë shtetit u dëmtua për shkak të përmblytjeve në zonë. Ndërtesa u ble më 1 janar 2021 me \$25 milion kur kursi i këmbimit ishte 2 dollarë ndaj 1 euro.

Ndërtesa bartet me kosto. Më 31 dhjetor 2021, shuma e rikuperueshme e ndërtesës u konsiderua \$17.5 milionë. Kursi i këmbimit në 31 dhjetor 2021 ishte 2.5 dollarë ndaj 1 euro. Ndërtesat zhvlerësohen për 25 vjet. Baza tatimore dhe vlera kontabël e pasurive afatgjata përpara zhvlerësimit ishin të njëjta. Zhvlerësimi i pasurive afatgjata nuk është i lejueshëm për qëllime tatimore. Barva sh.a nuk ka bërë asnjë zhvlerësim apo rregullim tatimor të shtyrë për sa më sipër. Barva sh.a pret të bëjë fitime për të ardhmen e parashikueshme dhe të supozojë se norma tatimore është 25%. Asnjë efekt tjetër tatimor i shtyrë nuk duhet të merret parasysh përveç pasurive afatgjata të mësipërme.

Kërkohet:

- i) **Vlerësoni pranueshmërinë e praktikave të mësipërme kontabël sipas SNK 36: Dëmtimi i pasurive. (6 pikë)**
- ii) **Rekomandoni trajtimin kontabël të transaksionit të mësipërm për drejtorët e Gyamfi për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021, duke përfshirë ekstraktet e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar përkatës. (5 pikë)**

b) Galeras sh.a bleu të gjitha aksionet e ekuitetit në Sakurajima sh.a në 1 janar 2019 për një shumë prej €1,250 milion. Vlera kontabël dhe vlera e drejtë e pasurive neto të identifikueshme gjatë blerjes ishin €1,230 milion. Më 31 dhjetor 2021, Galeras sh.a ishte në proces të shitjes së të gjithë aksioneve të saj në Sakurajima sh.a, dhe kështu u vendos që Sakurajima sh.a të trajtohej si një grup nxjerrje jashtë përdorimit i mbajtur për shitje në përputhje me SNRF 5 Pasuritë jo - qarkulluese të mbajtura për shitje dhe veprimtaritë e ndërprera në atë datë. Vlera

kontabël e pasurive neto të Sakurajima sh.a përpara klasifikimit si të mbajtura për shitje më 31 dhjetor 2021 në pasqyrën individuale të pozites financiare janë si më poshtë:

	€'milion
Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet	836
Pasuritë e paprekshme (perjashtuar zerin e mirë)	428
Pasuritë qarkulluese (sipas shumës së rikuperueshme)	584
Detyrimet afatgjata	(322)
Detyrimet afatshkurtëra	<u>(254)</u>
	1,272

Grupi ka një politikë të rivlerësimit të pasurive të patundshme, impianteve të prodhimit dhe pajisjeve të tij në përputhje me SNK 16 *Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet*. Nuk ka pasur rivlerësime ose ndonjë fitim ose humbje tjetër të përfshirë brenda komponentëve të ndryshëm të ekuitetit të Sakurajima sh.a që nga data e blerjes pasi vlera kontabël u konsiderua si një përafrim mjaft i afërt me vlerën e drejtë të saj. Megjithatë, më 31 dhjetor 2021, prona me vlerë kontabël prej €330 milion u konsiderua se kishte një vlerë të drejtë prej €340 milion. Asnjë rregullim nuk është bërë ende për këtë vlerë të drejtë. Vlera totale e drejtë minus kostot për shitjen e grupit të nxjerrjes jashtë përdorimit më 31 dhjetor 2021 u vlerësua të ishte €1,220 milionë. Nuk ka pasur dëmtime të mëparshme të emrit të mirë të Sakurajima sh.a.

Kërkohet:

Rekomandoni drejtorëve të Galeras sh.a se si transaksioni i mësipërm duhet të kontabilizohet në pasqyrat financiare të konsoliduara më 31 dhjetor 2021 duke përfshirë ekstraktet e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Raportimit Financiar përkatëse.

(9 pikë)

(Total: 20 pikë)

3

a)

i)

- Norma e skontimit e përdorur nga Barva sh.a nuk është llogaritur në përputhje me kërkesat e SNK 36 *Dëmtimi i pasurive*. Sipas SNK 36, rrjedhat e ardhshme të parasë vlerësohen në valuten në të cilën do të gjenerohen dhe më pas skontohen duke përdorur një normë skontimi të përshtatshme për atë valutë. SNK 36 kërkon që vlera e tanishme të përkthehet duke përdorur kursin e këmbimit në datën e llogaritjes së vlerës në përdorim.
- Për më tepër, valuta në të cilën janë shprehur rrjedhat e vlerësuara të parasë ndikon në shumë prej inputeve në llogaritjen e KMPK-së, duke përfshirë normën e interesit pa rrezik.
- Barva sh.a ka përdorur normën e obligacioneve shtetërore 10-vjeçare për juridiksionin e saj si normë pa rrezik në llogaritjen e normës së skontimit. Meqenëse normat e obligacioneve qeveritare ndryshojnë midis vendeve për shkak të pritshmërive të ndryshme për inflacionin e ardhshëm, vlera në përdorim mund të llogaritet gabimisht për shkak të pabarazisë midis inflacionit të pritshëm të reflektuar në rrjedhat monetare të vlerësuara dhe normës pa rrezik.
- Sipas SNK 36, norma e skontimit duhet të pasqyrojë rreziqet specifike për pasurinë. Prandaj, një normë skontimi për të gjitha NJGJP -të nuk përfaqëson profilin e rrezikut të secilës NJGJP. Norma e skontimit në përgjithësi duhet të përcaktohet duke përdorur KMPK të NJGJP-së ose të kompanisë, pjesë e së cilës është aktualisht NJGJP -ja. Përdorimi i KMPK-së së një kompanie për të gjitha NJGJP -të është i përshtatshëm vetëm nëse rreziqet specifike që lidhen me NJGJP-të specifike nuk ndryshojnë materialisht nga pjesa tjetër e grupit. Në rastin e Barva sh.a, kjo nuk është e dukshme.

ii) Për t'iu përgjigjur kësaj pyetjeje kërkohet një numër SNK-sh, të cilat përfshijnë njohuritë për SNK 16 *Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet*, SNK 36 *Dëmtimi i pasurive*, SNK 12 *Tatimet* dhe SNK 21 *Efektet e ndryshimeve në kursin e këmbimit të valutave të huaja*:

- Shuma kontabël e ndërtesës më 31 dhjetor 2021 = (25 - 1 zhvlerësimi) milion, d.m.th. \$24 milion / 2 = €12 milion.
- Shuma e rikuperueshme e ndërtesës më 31 dhjetor 2021 (\$17.5 milionë/2.5) = €7milion.
- Dëmtimi në fitim ose humbje = €5 milion (€12 milion - €7 milion)
- Baza tatimore dhe vlera kontabël e pasurive afatgjata janë të njëjta përpara shpenzimit të zhvlerësimit. Pas shpenzimit të zhvlerësimit do të ketë një diferencë prej €5 milion.

Kjo do të krijoj një pasuri të tatimit të shtyrë prej of €5 milion x 25%, = €1.25 milion.

Meqenëse Barva sh.a pret të ketë fitime në të ardhmen e parashikueshme, kjo mund të njihet në pasqyrat financiare.

Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e perfunduar me 31 dhjetor 2021 ekstrakt

	€ milion
Dëmtimi i ndërtesës	(5)
Zhvlerësimi i ndërtesës (\$25 milion/25 vite = \$1/2	(0.5)

Pasqyra e pozitës financiare për vitin e perfunduar me 31 dhjetor 2021 ekstrakt

	€ milion
Pasuritë jo-qarkulluese:	
Pasuritë e tatimit të shtyrë	1.25
Ndërtesa (12 - 5)	7

b)

- Emri i mirë në Sakurajima sh.a fillimisht do të llogaritet si €20 milionë euro (€1,250 milion - 1,230 milion). Pasuritë neto në Sakurajima sh.a tani janë €1,292 milion më 31 dhjetor 2021 (€1,272 milion sipas pyetjes dhe €20 milion).
- Meqenëse grupi ka një politikë rivlerësimi sipas SNK 16 *Pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet*, grupi duhet të rivlerësojë pronën dhe pajisjet e Sakurajima sh.a në vlerën e drejtë prej €340 milion në klasifikimin si të mbajtur për shitje. Një fitim prej €10 milion (€340 milion - €330 milion) do të regjistrohet brenda komponentëve të tjerë të ekuitetit.
- Pasuritë neto të Sakurajima sh.a tani do të kishin një vlerë kontabël prej €1,302 milion, përfshirë €846 milion për pasuritë e patundshme, impiantet e prodhimit dhe pajisjet. Në klasifikimin si të mbajtur për shitje, Sakurajima sh.a duhet të matet me vlerën më të ulët midis vlerës kontabël dhe vlerës së drejtë minus kostot për shitje. Një dëmtim prej €82 milion (€1,302 - €1,220).
- Kjo do t'i akordohet fillimisht emrit të mirë prej €20 milion. Dëmtimi i mbetur prej €62 milion shpërndahet për pasuritë afatgjata për të cilat zbatohen kërkesat e matjes të SNRF 5 *Pasuritë jo - qarkulluese të mbajtura për shitje dhe veprimtaritë e ndërprera*. Prandaj, asnjë dëmtim nuk do të shpërndahet në pasuritë qarkulluese të Sakurajima sh.a.

Tabela e mëposhtme përmbledh alokimin e dëmtimit:

	Blera bartëse	Dëmtimi	Vlera bartëse pas dëmtimit
	€ milion	€ milion	€ milion
Zëri i mirë	20	(20)	-
Pasuritë e patund., impian. e prodhimit dhe pajisjet	846	(41)	805
Pasuritë tjera të prekshme	428	(21)	407
Pasuritë qarkulluese	584	-	584
Detyrimet afatgjata	(322)	-	(322)
Detyrimet afatshkurtëra	<u>(254)</u>	<u>-</u>	<u>(254)</u>
Total	1,302	(82)	1,220

Pasqyra e pozites financiare (ekstrakt)

€ milion

Pasuritë qarkulluese:

Pasuritë qarkulluese - mbajtur per shitje (805+407+584) 1,796

Ekuiteti dhe detyrimet

TTGJ - Fitimi nga rivlerësimi (340 - 330) 10

Detyrimet afatshkurtëra:

Detyrimet afatshkurtëra - mbajtur per shitje (322 + 254) 576

Pasqyra e Fitimit ose humbjes (ekstrakt)

€ milion

Dëmtimi (82)

4. Yomba sh.a operon zinxhirë supermarketesh në gjashtëmbëdhjetë (16) rajone të Kosovës. Kompania ka qenë në funksionim tregtar për më shumë se dy dekada, duke rritur operacionet e saj përmes një zinxhiri furnizimi efektiv dhe menaxhimit financiar. Megjithatë, në vitet e fundit, konkurrenca e fortë dhe përkeqësimi i performancës së përgjithshme ekonomike kanë ndikuar në rritjen e qëndrueshme të përjetuar ndër vite, duke rezultuar në heqjen e një pjese të operacioneve nga kompania. Më poshtë janë pasqyrat financiare të Yomba sh.a.

**Pasqyra e fitimit ose humbjes për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021
(me informatat krahasuese)**

	2021			2020		
	Operacionet e vazhd.	Operacionet e ndërprera	Total	Operacionet e vazhd.	Operacionet e ndërprera	Total
	€000	€000	€000	€000	€000	€000
Të hyrat	37,400	5,650	43,050	31,350	7,440	38,790
Kosto e shitjeve	<u>(32,190)</u>	<u>(4,830)</u>	<u>(37,020)</u>	<u>(26,030)</u>	<u>(6,390)</u>	<u>(32,420)</u>
Fitimi bruto	5,210	820	6,030	5,320	1,050	6,370
Kostot e shperndarjes	(1,302)	(425)	(1,727)	(1,160)	(502)	(1,662)
Shpenzimet adm.	(2,225)	(657)	(2,882)	(1,330)	(460)	(1,790)
Interesi	<u>(340)</u>	<u>(12)</u>	<u>(352)</u>	<u>(284)</u>	<u>(31)</u>	<u>(315)</u>
Fitimi/(humbja) para tatimit	1,343	(274)	1,069	2,546	57	2,603
Shpenzimet e tatimit	<u>(826)</u>	<u>50</u>	<u>(776)</u>	<u>(1,210)</u>	<u>(45)</u>	<u>(1,255)</u>
Fitimi për periudhën	517	(224)	293	1,336	12	1,348

Pasqyra e pëmbledhur e pozitës financiare me 31 dhjetor 2021 (me informatat krahasuese)

	2021	2020
	€000	€000
Pasuritë jo-qarkulluese	11,775	14,080
Pasuritë qarkulluese:		
Stoqet	4,986	5,445
Pasuritë tjera qarkulluese	4,044	6,525
Total pasuritë	20,805	26,050
Kapitali aksionar & rezervat	8,896	8,798
Detyrimet afatgjata:		
Kredia	5,800	9,100
Detyrimet afatshkurtera	6,109	8,152
Total ekuieti dhe detyrimet	20,805	26,050

Informata shtesë

- i) Në një mbledhje të aksionarëve kryesorë dhe kreditorëve të mbajtur më 30 qershor 2021, u mor një vendim për të shitur të gjitha operacionet e një prej dyqaneve më të mëdha të shitjes me pakicë të kompanisë, si përgjigje ndaj vështirësive operative që filluan në fillim të periudhës aktuale. Operacionet, megjithatë, vazhduan deri më 31 shtator 2021, kur transaksioni i shitjes përfundimisht u mbyll dhe të ardhurat u morën. Rezultatet nga këto operacione për periudhën aktuale janë paraqitur veçmas në pasqyrën e mësipërme të të ardhurave. Humbja nga shitja e operacioneve në vlerë prej €217,000 është përfshirë në shpenzimet administrative.

- ii) Më 31 dhjetor 2021, pati një proces gjyqësor dhe padi në vlerë prej €2.05 milion kundër kompanisë nga një furnizues, kontrata e të cilit ishte ndërprerë si pjesë e procesit të mbylljes. Avokati ligjor e ka këshilluar kompaninë se ka një mbrojtje të mirë kundër pretendimit prandaj asnjë provizion nuk është bërë në lidhje me detyrimin e mundshëm në këto pasqyra financiare.
- iii) Koeficientët e mëposhtëm janë llogaritur bazuar në pasqyrat financiare të vitit 2020 të Yomba sh.a.

Marzha e fitimit bruto	16.42%
Marzha e fitimit para interest dhe tatimit	6.71%
Kthimi në ekuitet	15.32%
Kthimi në kapitalin e angazhuar	16.30%
Qarkullimi i stoqeve	5.95
Koeficienti qarkullues	1.47
Qarkullimi i pasurive	2.17
Koeficienti borxh/ (borxh + ekuitet)	50.84%

Kërkohet:

Shkruani një raport për Bordin e Drejtorëve duke analizuar performancën dhe pozitën financiare të Yomba sh.a-së, duke tërhequr vëmendjen e tyre për efektet (ose efektet e mundshme) të operacioneve të ndërprera dhe të kontigjencave në performancën e përgjithshme.

(20 pikë)

Raport

Për: Bordin e drejtorëve të Yomba sh.a

Nga: kontabilisti

Data: 22 janar 2022

Tema: Analiza e performancës dhe pozitës financiare të Yomba sh.a

Pas diskutimit që patëm për temën e mësipërme, ky raport është dorëzuar për shqyrtimin tuaj. Raporti shqyrton rentabilitetin, menaxhimin e kapitalit qarkullues dhe leverazhin e kompanisë për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2021, kundrejt periudhës së saj krahasuese. Ky raport duhet lexuar me shtojcën e bashkangjitur

Rentabiliteti

Ka pasur një përmirësim të pjesshëm të të ardhurave në vitin 2021 krahasuar me vitin 2020. Kjo rritje e qëndrueshme e të ardhurave rezultoi kryesisht për shkak të ndërprerjes së dyqanit me pakicë. Dyqani i shitur kontribuoi me 13.12% të të ardhurave totale të gjeneruara në 2021 kundrejt 19.18% në 2020. Megjithatë, kompania nuk mundi të mbante kostot e saj operative në përputhje me ndryshimet e të ardhurave pasi të gjitha matësit e rentabilitetit kanë rënë në 2020.

Menaxhmenti ia doli keq në kontrollin e kostove direkte të tregtimit dhe shpenzimeve të përgjithshme pasi marzha bruto e fitimit si dhe marzha e fitimit neto ka rënë. Një analizë e veçantë e kryer mbi marzhat ndërmjet operacioneve të vazhdueshme dhe atyre të ndërprera zbulon se ndërkohë që operacionet e ndërprera mund të kenë kontribuar ndjeshëm në marzhat e dobëta operative, veçanërisht për shkak të humbjes së regjistruar nga nxjerrja jashtë përdorimit, kjo pjesë e kompanisë operoi me marzha bruto më të mira se pjesa tjetër e kompanisë. Prandaj, kompania ka të ngjarë të mos bëhet më e mirë pas shitjes së operacioneve nëse kontrollet e kostos nuk shtrëngohen ndjeshëm për operacionet e mbetura.

Marzhet e ulëta kanë pasur një ndikim jashtëzakonisht negativ në kthimet e bëra për ofruesit e kapitalit në vitin 2021. Si kthimi në kapitalin e perdorur ashtu edhe kthimi në ekuitet kanë rënë ndjeshëm edhe pse kompania ka parë disa përmirësime të dukshme në qarkullimin neto të pasurive dhe stoqeve. Qarkullimi i pasurive tregon se firma i ktheu burimet e saj afërsisht tre herë në shitje këtë vit kundrejt pak më shumë se dy herë në 2020.

Kështu, rënia erentabilitetit mund t'i atribuohet qartë niveleve të larta të kostos operative.

Menaxhimi i kapitalit qarkullues

Në përgjithësi, kapitali qarkullues është menaxhuar efektivisht nga Yomba sh.a. Me një koeficient qarkullues prej 1.48 në vitin 2021, pasuritë qarkulluese të Yomba sh.a ofrojnë një mbulim të mirë për detyrimet e saj afatshkurtra. Dhe ky koeficient është pak më i lartë nga 1.47 që kishte në vitin 2020. Koeficient qarkullues mat se sa mirë është pozicionuar një firmë për të aplikuar pasuritë qarkulluese për të shlyer detyrimet afatshkurtra kur ato maturohen. Koeficient qarkullues prej 1,48 nënkupton që kompania mban €1.48 të pasurive qarkulluese për të paguar çdo €1 të detyrimeve afatshkurtër. Si një masë e kujdesit, Yomba sh.a arrin një normë të mirë të qarkullimit të stoqeve dhe regjistron një përmirësim të qartë gjatë vitit 2021. Kjo duhet të zvogëlojë çdo frikë nga shqetësimet e likuiditetit. Me qarkullimin stoqeve prej 7.42 (kundër 5.95 në 2020), kompania është në gjendje të zbrazë magazinën e saj mesatarisht 7.5 herë brenda vitit 2021, kundrejt afërsisht 6 herë në vitin 2020. Situata e fortë e likuiditetit është ndihmuar më tej nga Yomba sh.a. një firmë e shitjes me pakicë e cila e bën më të mundshme që ajo të konvertojë burimet në pasuri qarkulluese me një normë të përsheptuar.

Megjithatë, nëse detyrimi i kontigjent do të kristalizohej shpejt, ai do të kishte një efekt të dëmshëm mbi likuiditetin duke e ulur atë nën nivelin e 2020-ës.

Leverazhi

Kjo mat masën në të cilën firma financon operacionet e saj me fonde të siguruara nga palë të jashtme. Investitorët dhe huadhënësit përcaktojnë se ndaj çfarë rreziku i ekspozon firma. Përqindja e borxheve në totalin e kapitalit afatgjatë ka shënuar rënie, siç tregohet nga raporti i leverazhit. Ndërsa pak më shumë se gjysma e totalit të burimeve në 2020 u siguruan nga huadhënësit, rreth gjashtë për qind e totalit të fondeve erdhën nga brenda në 2021. Reduktimi i borxhit të përdorur nënkupton që firma po përballet me rrezik më të ulët financiar tani dhe kompania duket e shëndetshme. Por nëse shqetësimet e rentabilitetit nuk përmisohen shpejt mbajtja edhe e nivelit minimal të leverazhit mund të jetë e paqëndrueshme.

Konkluzion

Analiza e mësipërme ka zbuluar se rentabiliteti i Yomba sh.a është përkeqësuar dhe kostot operacionale duken jashtë kontrollit. Megjithatë, likuiditeti, efikasiteti dhe nivelet e leverazhit nuk paraqesin ndonjë shqetësim. Prandaj, menaxhmenti inkurajohet që të fillojë hetimin për të zbuluar mënyrën më të mirë që mund të kontrollojë kostot dhe të konsolidojë pozicionin e tij të fortë.

Unë jam në dispozicion për të dhënë çdo sqarim të mëtejshëm, nëse është e nevojshme.

Ju faleminderit
(nënshkrimi)
Kontabilisti

Shtojca

Koeficienti	Formula	2020	2019(dhenë)
Marzha e fitimit bruto	Fitimi bruto/shitjet x 100	6,030/43,050x100 = 14.01%	16.42%

5.

a) Drejtorët e Unzendake sh.a besojnë se disa Standarde Ndërkombëtare të Raportimit Financiar nuk janë në përputhje me Kornizën. Ata kanë bërë komentet e mëposhtme:

- (i) Njohja e një shpenzimi në lidhje me një skemë të pagesave të bazuara mbi aksione që shlyhen me ekuitet, në përputhje me SNRF 2 *Pagesat e bazuara në aksione*, nuk është në përputhje me përkufizimin e Kornizës për një shpenzim.
- (ii) Markat tregtare të krijuara nga brenda plotësojnë përkufizimin e një pausrie dhe kështu fakti që SNK 38 *Pasuritë e patrupëzuara* ndalon njohjen e tyre në pasqyrat financiare bie ndesh me Kornizën.

Kërkohet:

Diskutoni nëse secili nga komentet e drejtorëve është i vlefshëm. (6 pikë)

b) Biznesi i Nevado del Ruiz sh.a është blerja dhe shitja e traktorëve. Ata blejnë traktorë nga Mbretëria e Bashkuar. Më 10 dhjetor 2021, Nevado del Ruiz sh.a bleu pesë traktorë që kushtonin £20,000 secili me afat pagese 3 muaj. Kursi i çastit (spot) i këmbimit valutor në atë datë ishte 1 sterlina e barabartë me 1.25 euro. Valuta funksionale e Nevado del Ruiz sh.a është Euro. Me 31 dhjetor 2021 kursi i çastit (spot) i këmbimit valutor ishte 1 sterlina e barabartë me 1.30 euro.

Kërkohet:

Tregoni hyrjen në ditar që kërkohet për të përfshirë transaksionin e mësipërm në pasqyrat financiare të Nevado del Ruiz sh.a. për vitin e përfunduar me 31 dhjetor 2021. (4 pikë)

c) Thera sh.a ka një kredi bankare afatgjatë e cila është subjekt i kushteve të marrëveshjes së kredisë. Në marrëveshjen e kredisë thuhet se këto kushte do të vlerësohen në fund të çdo tremujori dhe do të raportohen në bankë brenda 30 ditëve të ardhshme. Nëse kushtet shkelen, kredia do të ri-paguhet menjëherë. Në fund të vitit që përfundon me 31 dhjetor 2021, Thera sh.a përcakton se nuk është në shkelle të kushteve, por Thera sh.a beson se ka të ngjarë që kushtet e marrëveshjes së huasë do të shkelen në tremujorin e ardhshëm.

Kërkohet:

Trego se si duhet ta klasifikoj dhe prezantoj Thera sh.a kredine e saj ne pasqyrat financiare të vitit të përfunduar me 31 dhjetor 2021. (5 pikë)

d) Përdorimi i faktorëve kritikë të suksesit në përgjithësi ndihmon në përcaktimin e kërkesave për informacione të menaxhmentit të lartë.

Kërkohet:

- i) Shpjego qasjen sipas të cilës përkufizohen faktorët të cilët janë kritikë për suksesin e menaxhmentit gjatë kryerjes së funksioneve të veta ose gjatë marrjes së vendimeve. (3 pikë)
- ii) Trego dallimin ndermjet faktorëve monitorues kyç të suksesit dhe faktorëve ndërtues kyç të suksesit. (2 pikë)

5.

(a)

Pagesa e bazuar në aksione

Korniza përcakton një shpenzim si një dalje në përfitimet ekonomike që rezultojnë në zvogëlim të ekuitetit (përveç atyre që lidhen me shpërndarjet për pjesëmarrësit e ekuitetit). Në rastin e një pagese të bazuar në aksion që shlyhet me para të gatshme, entiteti ka një detyrim për të paguar para të gatshme në të ardhmen. Prandaj, kjo plotëson përkufizimin e një shpenzimi. Megjithatë, në rastin e një pagese të bazuar në aksione që shlyhet me ekuitet, entiteti siguron ekuitetin si pagesë për mallin/shërbimin. Prandaj nuk ka reduktim të një pasurie ose rritje të një detyrimi në përputhje me përkufizimin e një shpenzimi. Në të vërtetë, një pagesë e bazuar në aksione e shlyer me ekuitet nuk ka ndikim neto në ekuitet (shpenzimet ulin fitimet e pashpërndara, por ana tjetër e transaksionit rrit komponentët e tjerë të kapitalit neto). Megjithëse SNRF 2 *Pagesat e bazuar në aksione* kërkon njohjen e një shpenzimi për skemat e pagesave të bazuara mbi aksione që shlyhen me ekuitet, mund të argumentohet se kjo nuk është në përputhje me përkufizimet në Kornizë.

Markat tregtare e krijuara nga brenda

Korniza përcakton një pasuri si një burim të kontrolluar nga një entiteti si rezultat i një ngjarjeje të kaluar që do të çojë në një hyrje të mundshme përfitimesh ekonomike. Markat tregtare, qofshin të krijuara nga brenda ose të blera, për këtë arsye përmbushin përkufizimin e një pasurie. Korniza thotë se zërat njihen në pasqyrat financiare nëse plotësojnë përkufizimin e një elementi dhe nëse kostoja ose vlera mund të maten me besueshmëri. Kostoja e një marke tregtare e krijuar nga brenda nuk mund të matet me besueshmëri. Kjo është për shkak se kostot e zhvillimit të një marke tregtare nuk mund të ndahen nga kostot e përditshme të biznesit. Prandaj, fakti që markat tregtare të krijuara nga brenda nuk njihen në pasqyrat financiare është në përputhje me Kornizen.

b)

Fillimisht, ne duhet të llogarisim shumën totale të borxhit në stërlina dhe ta konvertojmë atë shumë stërlinash në euro, d.m.th. $20,000 \text{ £} \times 5 = 100,000$ stërlina. Kursi i këmbimit spot është se 1 stërlina është e barabartë me 1.25 euro. Prandaj, 100,000 stërlina është e barabartë me 125,000 €, pra $100,000 \times 1.25$. Hyrja në ditar është si më poshtë:

D	Blerjet	€25,000	
K	Të pagueshmet tregtare	€25,000	

Me 31 dhjetor të pagueshmet tregtare duhet të rillogariten me kursin e këmbimit spot 1.30

D	Humbja nga këmbimet valutore: F/H	€ 1,000	
K	Të pagueshmet tregtare		€ 1,000

c) Thera sh.a duhet ende të klasifikojë kredinë si afatgjatë në datën e raportimit. Fakti që parashikohet një shkelje e ardhshme e kushteve të kredisë nuk e ndryshon gjendjen e kredisë në datën e raportimit.

d)

i) Qasja sipas të cilës përkufizohen faktorët të cilët janë kritikë për suksesin e menaxhmentit gjatë kryerjes së funksioneve të veta ose gjatë marrjes së vendimeve është si vijon.

Hapi 1 Renditni objektivat dhe synimet e organizatës si korporatë.

Hapi 2 Përcaktoni se cilët faktorë janë kritikë për përmbushjen e objektivave.

Hapi 3 Përcaktoni një numër të vogël të masave kryesore matëse për secilin faktor.

ii) Mund të identifikohen dy lloje të veçanta të faktorëve kritikë të suksesit. Faktorët monitorues kyçë të suksesit përdoren për të vendosur në të njëjtën vijë aktivitetet dhe operacionet ekzistuese të organizatës. Faktorët ndërtues kyçë të suksesit ndihmojnë me ndërmarrjen dhe përmbushjen me sukses të iniciativave të reja dhe ka më shumë gjasa të përdoren nga menaxhmenti i lartë ekzekutiv.